

SHOQËRIA AKSIONARE

SCAN SH.A.

Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS K12312001A
Me seli regjistruar në adresën: Rruga Aleksandër Moisiu, Ish-Kinostudio, godina e Kinofilmit, Tiranë

VENDIM

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot më 26.09.2022 (dymijë e njëzet e dy) në orën 10.00, në selinë e shoqërisë Scan SH.A. me NUIS K12312001A (më tej referuar si 'Shoqëria'), u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SH.P.K., një shoqëri e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, dhe e përfaqësuar ligjërisht nga Znj. Edlira Muka në cilësinë e administratorit të shoqërisë ('Aksionari').

Znj. Edlira Muka, e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Znj. Migena Kolonja të kryejë funksionin e sekretarit të mbledhjes.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

REND DITE

- I. **RRITJA E KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË;**
- II. **TË NDRYSHME**

NË LIDHJE ME PIKËN E PARË NË REND TË DITËS, Ortaku i Vetëm parashtron se Kapitali aktual i Shoqërisë është **466.153.808 LEK** (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetë lekë), i cili përbëhet nga 4,661,538 aksione.

Aktualisht Shoqëria ka miratuar pasqyrat financiare të shoqërisë "SCAN" SH.A për vitin financiar 2021 (dy mijë e njëzet e një) ku është vendosur që vlera totale e humbjes prej **251,587,225 LEK (Dyqind e pesëdhjetë e një milion e pesëqind e tetëdhjetë e shtate mijë e dyqind e njëzet e pese LEK)** do të mbulohet nga kapitali aksionar i Shoqërisë, sipas vendimit me të dhënat si më poshtë:

- Vendimi i Asamblese se Përgjithshme të Shoqërisë të datës 30.06.2022 (dy mijë e njëzet e dy) që miraton mbulimin e humbjes në vlerën prej **251,587,225 LEK (Dyqind e pesëdhjetë e një milion e pesëqind e tetëdhjetë e shtate mijë e dyqind e njëzet e pese LEK)** nga kapitali aksionar i shoqërisë; Ky Vendim është depozituar në rregjister më datë 11.08.2022 sëbashku me Depozitim të Pasqyrave Financiare 2021 (dy mijë e njëzet e një), të cilat janë miratuar nga QKB-ja.

Gjithashtu, Ortaku i Vetëm për motive operationale ka parë te arsyeshme dhe propozon rritjen e kapitalit në vlerën prej **80,294,000 Lekë (tetëdhjetë milion e dyqind e nentëdhjetë e katër mijë Lek)**.

Pas rritjes, kapitali i Shoqërisë nga vlera prej 214.566.583 LEK (dyqind e katërmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre lekë) – ku është zbritur paraprakisht vlera prej 251,587,225 LEK (Dyqind e pesëdhjetë e një milion e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njetzet e pese LEK) sipas vendimit të datës 30.06.2022 që miraton mbulimin e humbjes -, do të bëhet 294.860.583 LEK (Dyqind e nentëdhjetë e katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre lekë).


Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e kapitalit të Shoqërisë me kontribut në para në vlerën **80,294,000 Lekë (tetëdhjetë milion e dyqind e nentëdhjetë e katër mijë lek)**. Rritja e kapitalit do të realizohet me emetimin e **802,940 aksioneve të reja me të njëjtën vlerë nominale Shoqërisë të gjitha të nënshkruara nga aksionari i Shoqërisë. Pas rritjes, kapitali i regjistruar i Shoqërisë do të bëhet 294.860.583 LEK (Dyqind e nentëdhjetë e katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre lekë), i përbërë nga 2.948.605 aksione me vlerë nominale 100 Lekë secili.**
2. Autorizohet Admistratori, Znj. Vanova Strakosha që, duke vepruar personalisht ose duke autorizuar persona të tjerë të bëjë të mundur regjistrimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe në çdo institucion tjetër ku regjistrimi apo njoftimi është i kërkuar me ligj.


Meqenëse nuk ka çështje të tjera për diskutim, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

KRYETARI


Edlira Muka



SEKRETARI


Eva Veizaj